



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0548

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NOVUS SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, me 29/08/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE NOVUS SH.P.K., me nr. 2025/0548, e datës 27/06/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit" Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit" Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1 ndërkaq lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.11.2023 MINISTRIA E SHËNDETËSISË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 3,800,000.00 Euro.

Me 05.06.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 09.06.2025, OE NOVUS SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 19.06.2025.

Me 27.06.2025, OE NOVUS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokollit 2025/0548, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik NOVUS SH.P.K., lidhur me ankesën 0548/2025:

Pretendimi ankimor 1: OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PLOTËSUAR TË GJITHA PJESËT OBLIGATIVE TË DOSJES SË TENDERIT Në këtë Ankesë të tretë pranë OSHP-së, OE do ri-pohojë se ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të dosjes së tenderit. Në Njoftimin e Vendimit të AK, të datës 19.06.2025, AK ri-vlerëson Ofertën si të papërgjegjshme për këto arsye:

- 1) Referencat e ofruara nga OE janë të pamjaftueshme dhe nuk permbushin kërkesën e pikës 9.1 & 9.2 të Seksionit II, DT;
- 2) OE dështoi të ofrojë dëshmi të vlefshme të projekteve të ngjashme të përfunduara me sukses;
- 3) Katalogët e dorëzuar nga OE kanë mospërputhje ndaj specifikimeve të kërkuara në dosjen e tenderit:
 - a) Mospërputhje në serverin qendror; Propozimi nuk përmban përshkrime për mekanizmat e sigurisë së qasjes në të dhëna;

b) Mospërputhje në procesorët e ofruar; Procesori i ofruar nuk arrinë kërkesën minimale 2.0 GHz;

c) Mospërputhje në monitorët 6MP; Mungesa e detajeve për përshtatjen e drejtpërdrejtë të sistemit me pajisje specifike mjekësore.

Pas krahasimit të Njoftimit të datës 18.07.2024 për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, me Vendimin e datës 19.06.2025, shihet se pretendimet aktuale të AK nuk janë të njëjta me arsyetimin mbi të cilin AK e ka konsideruar ofertën e OE si të papërgjegjshme. Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK nuk ngrit çështjet që ka ngritur tani, prandaj duhet theksuar se AK nuk e ka vlerësuar ofertën si të papërgjegjshme në bazën e çështjeve të ngritura aktualisht në Vendimin e datës 19.06.2025.

AK në këtë Vendim shton se nuk ka trajtim jo të barabartë, për shkak se AK nuk ka krijuar kritere të reja gjatë procesit të rishqyrtimit, ashtu që t'i vështirësojë punën OE PACS and Workflow System. Mirëpo, AK vazhdimisht gjatë këtij procesi fillimisht i vlerëson disa kritere si të përmbushura, dhe më pas, në rast nevojë, mohon përmbushjen e tyre. Duke qenë se AK ka eliminuar OE Pacs and Workflow System për arsye të cilat më parë e ka vlerësuar si të përgjegjshëm, AK është në shkelje të nenit 7 të LPP-së i cili siguron trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik, ashtu që ofertën e përgjegjshme të OE Pacs and Workflow System vazhdon ta vlerësoj si të papërgjegjshme çdoherë për arsye të ndryshme vetëm me qëllim të eliminimit të tij dhe të anulimit të aktivitetit të prokurimit.

Vendimi i datës 19.06.2025 pretendon se miraton Vendimin për anulim të tenderit si të drejtë dhe të ligjshëm, megjithëse arsyetimi i Vendimit të datës 19.05.2025 devijon tërësisht nga arsyetimi për shpalljen e ofertës së papërgjegjshme; rrjedhimisht anulimin e tenderit. Vendimi i fundit i datës 19.05.2025 dështon që të ri-shqyrtojë si të ligjshëm dhe të drejtë Vendimin për anulim të tenderit, meqenëse për shkaqe vet-shërbyese dhe në kundërshtim me ligjin, AK plotësisht shmanget nga obligimi për të shqyrtuar arsyetimin fillestar për shpallje të ofertës si të papërgjegjshme, dhe përkundrazi zgjedh që të përpilojë arsyetim të ri dhe kundërthënës. Megjithëse në Njoftimin e parë AK eliminon OE pa shumë detaje, siç ceket nga vet AK në Vendimin e fundit, kjo nuk i jep AK të drejtë që të gjejë bazë plotësisht të re për eliminim sa herë që është e nevojshme.

Një veprim i tillë është në kundërshtim edhe me nenin 60.7 të Rregullores për Prokurim, i cili përcakton se kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton një ndryshim të rezultatit fillestar. Në të gjitha instancat e rikthimit në vlerësim nga OSHP për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka ndryshuar vlerësimet e saj mbi ofertën e OE Pacs and Workflow System, gjë që përforcon qëndrimin se AK ka për qëllim që të eliminoj ofertën e OE Pacs and Workflow System në çdo mënyrë të mundshme dhe të anuloj aktivitetin e prokurimit.

Duhet theksuar qartë se me Vendimin e OSHP-së të datës 19.06.2025, aktiviteti i prokurimit është kthyer për rivlerësim, e jo për rishqyrtim të plotë apo rivlerësim me baza të reja. AK ka tejkaluar mandatin e përcaktuar nga OSHP, duke përfshirë arsye të reja për eliminim të cilat nuk ishin përfshirë as në vendimin fillestar, as nuk ishin objekt i kontestimit nga OE në kërkesat për rishqyrtim.

Për më tepër, edhe pse OE ka paraqitur informata dhe dëshmi shtesë në kuadër të sqarimeve të kërkuara nga vetë AK – të cilat jo vetëm që përmbushin, por edhe tejkalojnë kërkesat e

përcaktuara në Dosjen e Tenderit – AK nuk i ka trajtuar këto dëshmi në mënyrë të drejtë dhe objektive. Injorimi i dëshmive relevante të ofruara nga OE bie ndesh me nenin 59 dhe 60 të LPP-së, si dhe përbën një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe mospërputhje me vendimin e OSHP-së për rivlerësim të drejtë dhe të kufizuar në çështjet e kontestuar.

Sjellje të tilla minojnë transparencën dhe integritetin e procesit të prokurimit publik dhe e vënë OE-në në një pozitë të padrejtë dhe diskriminuese.

Kështu, duke kundërshtuar gjitha pretendimet e lartcekura të AK, në vijim do të argumentojmë se OE Pacs and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe si e tillë duhet të shpërblehet me kontratë.

Në rrethanat e mësipërme, është e qartë se oferta e OE PACS and Workflow System është teknikisht dhe ligjërishit e përgjegjshme, dhe si e tillë duhej të shpërblehej me kontratë, në përputhje me nenin 60 të LPP-së. Prandaj, vendimi i AK-së për eliminimin e OE-së dhe për anulimin e aktivitetit të prokurimit duhet të anulohet si i pabazuar dhe i kundërligjshëm.

Pretendimi ankimor 2:

OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PARAQITUR OFERTË TË PËRGJEGJSHME

AK pretendon se OE nuk ka përmbushur kërkesën e paraqitur në pikat 9.1 dhe 9.2 për “Kërkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale”, Seksioni II i FTD. AK në këtë Vendim, ndryshe nga vendimi fillestar, pretendon se nuk ka mjaftueshëm dëshmi ligjërishit të vlefshme sa i përket demonstrimit që produkti është implementuar në shumë vende. AK ngritë këtë pikë për të cilën pretendon se ka pasur mos-përputhje në krahasim me kërkesat e tenderit, por asnjëherë nuk konteston me fakte kundërtënëse pohimet e OE PACS and Workflow System në Kërkesën për rishqyrtim, të datës 09.06.2025.

Për këtë arsye, argumentimi i OE PACS and Workflow System do të jetë i njëjtë si në Kërkesën për rishqyrtim. AK konteston se dokumentacionit të ofruar nga OE i mungon vula zyrtare dhe nuk përmbanë dëshmi të drejtpërdrejta nga marrësi i shërbimeve që është Ministria e Lituanië. Gjithashtu, pretendohet se dokumenti i ofruar në pyetje sqaruese nuk është ofruar nga Ministria e Shëndetësisë, që është përfituesi, por nga njëri prej anëtarëve të konsorcium, me ç'rast nuk plotësohen kërkesat nga AK, pasi që nga AK është kërkuar që të ofrohet referencë nga klienti, elementet e së cilës janë vula, nënshkrimi, të cilat janë thelbësore për të vërtetuar vlefshmërinë dhe bazueshmërinë ligjore të kërkesës. Duhet theksuar se dosja e tenderit nuk përmban kërkesën që referenca për implementimin e produktit të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga klienti përkatës.

Dëshmitë dhe dokumentacioni i dorëzuar sa i përket klientit Ministria e Lituanië përmban të gjitha elementet të cilat kërkohen për të konfirmuar se është implementuar me sukses projekti me arkitekturë me shumë faqe. Për më tepër, dosja e tenderit kërkon që me referencë të përfshihet edhe informatat kontaktuese për klientin ashtu që të mund të verifikohet kërkesa. Këto informata janë të përfshira në referencë, ku paraqitet personi kontaktues Osvaldas Grubys, së bashku me emailin kontaktues të tij.

Në këtë drejtim, AK ka shkelur nenin 60.2, i cili shprehimisht ndalon shtimin e kritereve të reja nga dosja e tenderit pas pranimit të tenderëve, duke kërkuar që referenca të jetë e vulosur nga klienti. Dëshmia e dorëzuar përmes MedDream si pjesëtar i grupit të operatorëve ekonomik

përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dosje e tenderit dhe oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme në lidhje me këtë kërkesë.

2) Gjithashtu, AK pretendon se OE ka ofruar dëshmi për projekte në vazhdueshmëri, e jo të përfunduara siç kërkohet. AK argumenton që datat e dokumenteve të paraqitura paraprakisht nga OE, dhe ato të paraqitura nga OE pas Kërkesës për sqarim e AK nr.4, nuk korespondojnë. Megjithatë, ky argument është i pabazë siç është vërtetuar në Kërkesën për rishqyrtim, mirëpo AK përsëri nuk konteston argumentet, por ri-përsërit pikat e veta pa sjellur arsye pse pretendimet e OE janë të pa baza. Është me rëndësi të theksohet se kjo çështje në vlerësimin e parë nga Autoriteti Kontraktues nuk është trajtuar si kriter i papërbushur, por është konsideruar si kriter i përmbushur dhe i pranuar nga ana e AK-së. Kjo çështje është trajtuar për herë të parë si problematike vetëm në fazën e dytë dhe të tretë të rivlerësimit, pra është shtuar si arsye e re për eliminim, gjë që bie ndesh me nenin 60.2 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe vendimin e OSHP-së për kthim në rivlerësim vetëm për çështjet e kontestuara fillimisht.

Paraprakisht, OE kishte specifikuar kohëzgjatjen e projektit të ngjajshëm nga 10.12.2021 dhe në vazhdueshmëri. Pas Kërkesës së AK për sqarim, OE klarifikon se arsyeja pse projekti është cilësuar si “në vazhdueshmëri”, është për shkak se projekti–veçse i implementuar–kërkon mirëmbajtje, të cilën OE e ofronte. Në përgjigjen sqaruese të OE, OE bashkangjet si provë referencën e palës përfituese nga Zelanda e Re, e cila konfirmon se në dhjetor 2021, siç është paraqitur në dokumentet e mëparshme të OE, është bërë implementimi i suksesshëm i projektit gjatë tre viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë; prandaj, OE përmbushë kërkesën në pikat 9.1 & 9.2 të Seksionit II të DT.

Rrjedhimisht, është e qartë nga dokumentacioni i dorëzuar se datat e përmendura përputhen me të dhënat kontraktuale, pasi që kontrata përfshinë faza të ndryshme të projektit, përderisa sistemi ka hyrë në prodhim dhe licensa është aktivizuar në Dhjetor 2021, në përputhje me datën e deklaruar nga OE Pacs and Workflow System. Për të verifikuar këtë, referenca e bashkëngjitur po ashtu përmban detajet e kontaktit përmes së cilës referenca mund të verifikohet. Prandaj, oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme edhe sa i perket kësaj kërkesë.

3) AK ka rivlerësuar ofertën si të papërgjegjshme duke kontestuar përshtatshmërinë e Katalogut të ofruar nga OE dhe Kërkesave të përcaktuara në DT.

AK pretendon se OE në kërkesë për rishqyrtim ka argumentuar se “Katalogët e ofruar nga OE janë paraqitur si vlerë shtesë e ofertës, pasi në kërkesat e Dosjes së Tenderit nuk ka qenë kërkesë dorëzimi i katalogëve të produkteve, pra, mospërputhjet në katalogë s’duhet të ishin bazë eliminimi”. Në të vërtetë, pjesa e fundit dhe e theksuar e fjalisë nuk figuron në asnjë shkresë të OE, për shkak se OE nuk ka bërë kurrë këtë pretendim, dhe në fakt është e shtuar nga AK megjithëse AK e paraqet sikur të cituar.

OE asnjëherë nuk ka pretenduar se mos-përputhjet në katalogë s’duhet të ishin bazë eliminimi. Në realitet, OE deklaroi se katalogët janë ofruar si vlerë shtesë në ofertë ashtu që të vërtetohet përputhshmëria, dhe jo të justifikohet mos-përputhshmëria, për shkak se nuk ekziston asnjë e tillë nga ana e ofertës së OE, siç do vërtetohet më tutje.

Katalogu i OE është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, për këto arsye:

a) AK përsëri konteston përputhshmërinë e Serverit të ofruar nga OE në krahasim me kërkesën sa i përket Serverit Qëndror, megjithëse OE në Kërkesë për rishqyrtim vërtetoi se Serveri përputhet me kërkesat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike në DT. AK pretendon se Serveri i ofruar nga OE, i cili është Dell PowerEdge R760xd2, nuk përshtatet me kërkesën e “opsionit për një panel të përparëm të kyçshem në kasën e serverit, që kufizon qasjen në hard disqe.”, mirëpo ky pretendim është i pabazë. Dell PowerEdge R760xd2 me të cilin është ofruar e përmban këtë opsion të bezel, ashtu si mund të konfirmohet nga linqet më poshtë:

https://www.dell.com/support/manuals/en-us/poweredge750/per750_ism_pub/installing-the-front-bezel?guid=guid-ed501cdf-f6f7-46f7-9d2e-aad1c5ba4387&lang=en-us&utm

chromeextension://efaidnbmninnibpcapjpcglclefindmkaj/https://i.dell.com/sites/csdocuments/Product_Docs/en/dell-emc-poweredge-r740xd2-technical-guide.pdf

Përkatesisht, në faqen zyrtare të prodhuesit DELL, përcaktohet se: “The Dell PowerEdge R750xd2 server features a lockable front bezel designed to enhance physical security by restricting unauthorized access to the drive bays and system controls. This bezel can be secured using a key lock mechanism, ensuring that only authorized personnel can access the servers front components.”

Sa i përket pjesës së ofrimit të modulit 4 x 10/25GbE SFP28, bazuar në ofertën teknike të paraqitur nga OE, është specifikuar se moduli përfshin 4 porta 10/25GbE SFP28, duke përfshirë gjithashtu edhe SFP transceiver-ët përkatës. Shih më poshtë ofertën e dorëzuar nga OE për këtë komponentë.

AK gjithashtu pa pasur të drejtë ngrit edhe një çështje të re që nuk e kishte përfshirë në Letrën e Eliminimit sa i përket serverit, ku kësaj rradhe shton se serveri nuk është i përshtatshëm për shkak se nuk përfshin opsionin sensor. Edhe pse AK nuk ka të drejtë që të shtojë arsye për eliminim, ky pretendim prapë se prapë është i pabazë. Dell PowerEdge R750xd2 posedon sistemin iDRAC 9, i cili përdoret për të monitoruar sigurinë e serverit, prandaj veçse përmbush kërkesën për sensor sigurie.

OE ri-përsërit argumentet e veta të mëparshme nga Kërkesa për rishqyrtim, meqenëse AK përsëri mohon se ky server është i përshtatshëm, mirëpo nuk e vërteton këtë. Pra, siç është argumentuar edhe më parë, në këtë pikë OE Pacs and Workflow System është tërësisht i përgjegjshëm.

b) Po ashtu, AK përsëri konteston përputhshmërinë e frekuencës së Procesorit, mirëpo nuk sjellë asnjë argument kundërtës ndaj argumenteve të OE në Kërkesë për Rishqyrtim. Për këtë arsye, OE detyrohet të ri-përsëris argumentet e mëparshme. Intel i9-13900 vPro që do përdoret në Kompjuterët Dell Precision 3460 SFF, të ofruar nga OE, përshtatet me Kërkesën e AK, që kërkon për një minimum 1.5 GHZ sa i përket bërthamave të efikasitetit, dhe minimum 2.0 GHZ sa i përket bërthamave të performancës. Për shkak se katalogu zyrtar i Dell thotë se Frekuenca e këtyre procesorëve është 1.5-5.6 GHZ, pa bërë ndasinë mes minimumeve të bërthamave efikase dhe atyre të performancës, AK pa bazë supozon që minimumi i frekuencës së bërthamave të performancës nuk është arritur. Në realitet, faqja zyrtare e Intel, prodhuesve të këtyre procesorëve, tregon se procesorët e ofruar arrijnë minimumin 2.0GHZ në bërthamat e performancës, siç e kërkon DT.

Për më shumë detaje, shih më poshtë ofertën teknike të dorëzuar nga Operatori Ekonomik.

Shih linkun më poshtë për verifikim:

<https://www.intel.com/content/www/us/en/products/sku/230499/intel-corei913900-processor-36m-cache-up-to-5-60-ghz/specifications.html>

Prandaj, edhe në këtë aspekt, oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme. c) Në fund, AK ri-pretendon se monitori mjekësor i ofruar nuk përmbush plotësisht kushtet teknike të kërkuara. Kjo për shkak se koha e përgjigjes së raportuar (18 ms mesatare Tr+Tf) nuk përputhet me metodologjinë e kërkuar on/off prej 25 ms, çka krijon pasiguri në performancën reale klinike. Gjithashtu, kalibrimi i ndriçimit në 600 cd/m² tejkalon kufirin e kërkuar prej 500 cd/m² dhe nuk është optimal për mjedisë të kontrolluara diagnostikuese me ndrigim të ulët. Ndërkohë që kontrasti i lartë prej 2000:1 mund të duket si avantazh, ai nuk përkon me standardin e kërkuar prej 1500:1, i cili lidhet me sistemet ekzistuese të kalibrimit dhe algoritmet e diagnostikimit.

Së fundmi, këndi i shikimit 178°/178° është jashtë specifikimit të kërkuar 176°/176°. Bazuar në ofertën teknike të paraqitur, është ofruar specifikimi teknik i mëposhtëm, duke u theksuar se është propozuar një model më i avancuar sesa ai i kërkuar në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, në krahasim ndërmjet kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ofertës së Operatorit Ekonomik, modeli Barco i ofruar tejkalon specifikimet bazë të kërkuara për monitorin mjekësor 6-Megapixel dhe konsiderohet si një zgjidhje më cilësore dhe me e rekomanduar.

Sipas Nenit 28, paragrafi 6, i LPP-së, AK nuk mund ta skualifikoj një operator ekonomik vetëm për faktin se shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet e formuluar. Në këtë drejtim, fakti se OE Pacs and Workflow System ka ofertuar me produkt më të avancuar dhe specifikacionet teknike të cilave jo vetëm që përmbushin minimalisht specifikimet teknike por edhe i tejkalojnë ato, nuk mund të eliminohet si ofertë e papërgjegjshme. Për më tepër, bazuar në përgjigjet e datës 30.01.2024, AK ka pranuar që mund të ofrohet me zgjidhje ekuivalente, për aq kohë sa ajo përmbush kërkesën përkatëse të kësaj pike, e cila është tërësisht në përputhje me Nenin 28, paragrafin 6 të LPP-së. Për të vërtetuar përmes sqarimeve përshtatshmerinë e katalogut të ofruar dhe atij të kërkuar nuk nevojiten domosdoshmërisht broshura ose fletë tjera teknike, siç pretendon AK.

OE përmes argumenteve më lartë vërtetoi më se mjaftueshëm përputhjen e katalogëve, prandaj çdo përpjekje e AK që të zhvlerësojë këto argumente të OE është vetëm tendencioze, dhe jo e bazuar. Rrjedhimisht, oferta e OE Pacs and Workflow System është tërësisht e përgjegjshme dhe si e tillë nuk është dashur të eliminohet. Në lidhje me pretendimet e AK-së për katalogët, duhet sqaruar se katalogët e dorëzuar nga OE nuk ishin të kërkuar në mënyrë obligative nga Dosja e Tenderit; ato janë ofruar vullnetarisht nga OE si material shtesë informues, me qëllim që të ilustrohet më tej përputhshmëria teknike e pajisjeve të ofruara.

Megjithatë, pavarësisht se katalogët nuk përbëjnë dokumentacion të kërkuar detyrimisht, OE ka ofruar dëshmi shtesë përmes faqeve zyrtare të prodhuesve, linqeve zyrtare, si dhe dokumentacionit teknik të pajisjeve përkatëse, të cilat konfirmojnë qartë që specifikimet e ofruara janë tërësisht në përputhje me kërkesat teknike të tenderit, dhe në disa raste edhe i tejkalojnë ato.

Për këtë arsye, mbështetja e AK-së vetëm në katalogë si bazë për eliminim, për më tepër kur ata nuk ishin pjesë obligative e dokumentacionit, është e pabazë në të drejtë dhe bie ndesh me parimin e vlerësimit të drejtë dhe objektiv të ofertës në bazë të dokumenteve të dorëzuara sipas kërkesave të tenderit. Për më tepër, duhet theksuar se gjatë procesit të rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Operatorit Ekonomik sqarime shtesë lidhur me disa prej elementeve teknike të ofertës së tij. OE PACS and Workflow System, në përputhje me kërkesën e AK-së, ka dorëzuar dokumentacion shtesë dhe dëshmi të plotë të cilat jo vetëm që përmbushin kriteret minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, por në disa raste i tejkalojnë ato ndjeshëm.

Megjithatë, AK nuk i ka trajtuar këto dëshmi në mënyrë objektive dhe profesionale, por ka vazhduar të mbajë qëndrim negativ ndaj ofertës së OE-së, duke injoruar argumentet dhe provat teknike të dorëzuara – përfshirë specifikimet zyrtare të pajisjeve të ofruara nga prodhues të njohur ndërkombëtarë (si Dell, Intel, Barco etj.). Kjo sjellje bie në kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilëve Autoriteti Kontraktues është i detyruar të vlerësojë ofertat në mënyrë të drejtë, objektive dhe bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit. Injorimi i provave shtesë dhe mosvlerësimi i tyre përbën një shkelje të rëndë procedurale dhe dëmton seriozisht integritetin e procesit të prokurimit publik. Në këtë kontekst, duhet theksuar gjithashtu se Vendimi i OSHP-së për kthimin në rivlerësim nuk ka dhënë autorizim për rishqyrtim të plotë apo shtim të bazave të reja për eliminim. AK ka vepruar në kundërshtim me këtë vendim, duke tejkaluar mandatin e saj dhe duke vendosur kriteret shtesë, në kundërshtim me nenin 60.2 dhe 67.7 të Rregullores për Prokurim Publik.

Rrjedhimisht, mbetet e qartë se oferta e OE PACS and Workflow System është teknikisht dhe ligjërisht e përgjegjshme dhe, si e tillë, nuk ka pasur arsye të ligjshme për eliminim. Kërkojmë nga OSHP që të konstatojë pavlefshmërinë e vendimit të AK dhe të urdhërojë shpërbimin me kontratë të OE, në përputhje me dispozitat e LPP-së., dhe rrjedhimisht, Vendimi i AK për eliminim të OE PACS and Workflow System duhet të anulohet si i kundërligjshëm.

Pretendimi ankimor 3:

NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE QË TË ANULOHEK AKTIVITETI I PROKURIMIT

Neni 62 i LPP-së, lexuar së bashku me nenin 43.5 të Rregullores për Prokurim, shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundohet një aktivitet i prokurimit.

Duke qenë se oferta e PACS and Workflow System është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kjo përkundër faktit se, siç është elaboruar edhe në pretendimet e mëparshme, OE PACS and Workflow System ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ekonomikisht të favorshme – me çmim nën vlerën e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues (AK).

Në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe që i plotëson të dy kriteret vendimtare për t'u shpërblyer me kontratë, AK nuk ka të drejtë të përfundojë aktivitetin e prokurimit, por është i obliguar të shpërblejë me kontratë OE-në që dorëzon ofertë të tillë. Për më tepër, duhet theksuar se më datë 09.06.2025, OE PACS and Workflow System ka paraqitur për herë të tretë Kërkesë për Rishqyrtim, me të cilën ka dëshmuar se oferta e tij është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa më datë 19.06.2025, AK nxjerr Vendimin për refuzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar, duke ndërmarrë në të njëjtën kohë

vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Përfundimisht, duhet theksuar se AK është duke tentuar që në mënyrë të kundërligjshme dhe pa ndonjë arsytim të vlefshëm, të shpall OE PACS and Workflow System si të papërgjegjshëm, me qëllim që t'i hapë rrugë shpërblimit të operatorëve tjerë ekonomikë. Ky veprim përbën shkelje të rëndë procedurale dhe cenon parimet e transparencës dhe konkurrencës në prokurimin publik. Duhet kujtuar se OSHP, në vendimin e saj të mëparshëm, ka pranuar ankesën e OE PACS and Workflow System si të bazuar, duke konstatuar se oferta e OE-së është e përgjegjshme dhe duke urdhëruar AK që të shpërblejë OE me kontratë, dhe jo të rikthejë tenderin në rivlerësim me kritere të reja.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigja e stafit teknik të komisionit të vlerësimit të Autoritetit Kontraktues:

Pretendimet e juaja ankimore janë trajtuar nga AK dhe pas shqyrtimit të tyre mund të konstatojmë se janë të pabazuara, në vijim gjeni arsyetimet për secilin pretendim:

Në Kërkesën tuaj për Rishqyrtim të datës 10.06.2025, ju keni paraqitur disa pretendime ankimore, me synimin për të kundërshtuar eliminimin tuaj dhe vendimin e AK për anulimin e aktivitetit. Në këtë shqyrtim, ne do t'i trajtojmë secilin nga këto pretendime dhe do t'ju ofrojmë përgjigje të faktuara për secilën prej tyre, duke u mbështetur në faktet e gjetura nga komisioni vlerësues si dhe dispozitat ligjore të prokurimit në fuqi.

Pretendimi 1: “GOE PACS and Workflow System ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të Dosjes së Tenderit.”

Ju pretendoni se i keni dorëzuar të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e kërkuara dhe se nuk ka mungesë apo mangësi formale në ofertën e juaj, duke përfshirë edhe referencat e kërkuara në pikat 9.1 dhe 9.2 të FDT. Ne e kundërshtojmë këtë pretendim si të pabazë, pasi gjetjet e seksionit të mësipërm tregojnë qartë se dokumentacioni juaj kishte mangësi serioze. Konkretisht, referencat e projektit nuk ishin në përputhje me kërkesat: ju keni paraqitur projekt ende në realizim (jo të përfunduar) dhe kur u kërkuar vërtetim me sqarime shpesh, ju nuk keni arritur ta vërtetoni, pasi që keni ofruar një dokument të jo bindës, jo nga subjekti përfitues i projektit (dokumenti është pa vullë).

Kërkesa e dosjes ishte për projekte të përfunduara me sukses dhe të vërtetuara zyrtarisht. Pra, një pjesë obligative e dosjes – dëshmia e përvojës së suksesshme – nuk u përmbush nga ju si OE, pavarësisht pretendimit tuaj. Autoriteti Kontraktues në njoftimin e eliminimit tuaj e ka theksuar këtë si arsye primare. Këtu vlen të kujtojmë që sipas LPP, mosplotësimi i qoftë edhe i një kërkesë kyçe të dosjes (p.sh. një kriter kualifikimi si referencat) e bën ofertën të papërgjegjshme. Pretendimi juaj sikur çdo gjë ishte në rregull thjesht nuk qëndron përballë fakteve: dokumenti i referencës ishte i mangët dhe i pasaktë. Po ashtu, edhe në aspektin teknik, ju keni deklaruar pajtueshmërinë me specifikimet, por siç shihet, kjo deklaratë ishte e gabuar – pra nuk mund të konsiderohet se “ka plotësuar gjithçka”, kur në realitet s'ka përmbushur kërkesat substanciale.

Pretendimi 2 (1, 2, 3): “OE PACS and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme.”

Këtu OE pretendon drejtpërdrejt se oferta e tij duhej trajtuar si e përgjegjshme (d.m.th. e vlefshme dhe e pranueshme). Në dritën e analizës së bërë nga komisioni, ky pretendim rrëzohet qartë. Sipas nenit 59 të LPP, për të qenë “e përgjegjshme”, oferta duhet të jetë në përputhshmëri

të plotë me të gjitha kërkesat e tenderit, me përjashtim të ndonjë devijimi të vogël/lehtësisht të korrigjueshëm.

Gjetjet tona tregojnë disa devijime aspak të vogla: mungesë e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit (referencat), dhe disa mospërputhje kritike teknike (te serveri, procesori, monitorët). Këto nuk janë gabime që mund të korrigjohen me sqarim të thjeshtë – p.sh. nuk mund t'i shtohet një bezel serverit përmes letrave, as të rritet frekuenca e procesorit me shpjegime. Janë mangësi objektive. OE u lejua të jepte sqarime gjatë rivlerësimit (duke dërguar katalogët dhe referencën shtesë), por sqarimet vetëm sa konfirmuan mospërputhjet në vend që t'i zgjidhnin ato (p.sh. katalogët zyrtarë konfirmuan mospërmbushjen e disa specifikimeve). Prandaj, oferta në tërësinë e saj nuk i përmbushi kriteret për t'u cilësuar e përgjegjshme. Duhet theksuar se asnjë nga devijimet e konstatuara nuk është i natyrës së ‘gabim shtypi’ apo lëshimit minimal; përkundrazi, secili prej tyre prek elemente që Autoriteti i kishte paraqitur si kërkesa të patjetërsueshme. Nëse do t'i injoronim ato, do të bëhej një trajtim jo i barabartë në mes ofertuesve dhe duke ju privilegjuar juve jashtë rregullave, gjë që ligji nuk e lejon (LPP nenet 7 dhe 59). Përmbledhur, pretendimi i OE se oferta e tij është e përgjegjshme bie ndesh me përkufizimin ligjor të “ofertës së përgjegjshme” dhe me provat faktike të mësipërme.

Pretendimi 3: “Autoriteti Kontraktues po vepron në mënyrë të padrejtë, duke ndryshuar here pas here arsyet e eliminimit të OF-së me qëllim për ta skualifikuar atë (“diskriminim”), në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së; gjithashtu, kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton që AK të dalë me arsye të reja (referencë ndaj nenit 67.7 të Rregullores së Prokurimit).”

Ky pretendim përmbledh në vetvete akuzën më serioze: OE insinuan se AK ka qenë i anshëm ndaj tij dhe se në secilin rivlerësim “ka shpikur” arsye të reja vetëm që oferta e OE-së të mos pranohet, gjë që OE e konsideron praktikë të padrejtë dhe jashtë kuadrit ligjor. OE përmend nenin 1 të LPP (barazia/jodiskriminimi) dhe nenin 67.7 të Rregullores (mosndryshimi i rezultatit fillestar pas rivlerësimit) për të mbështetur këtë pikë. Ne e marrim shumë seriozisht këtë pretendim, por pas analizës, arrijmë në konkluzionin se ai nuk qëndron dhe se AK ka vepruar brenda kornizës ligjore.

Së pari, sa i përket nenit 7 të LPP-së, parimi i barazisë dhe jodiskriminimit do të thotë se asnjë OE nuk duhet trajtuar ndryshe nga të tjerët pa shkak dhe se kriteret nuk duhet të ndryshohen arbitrarisht për të favorizuar apo përjashtuar dikë. Në këtë prokurim, të gjithë ofertuesit e tjerë (ka pasur disa grupe OE pjesëmarrës) janë eliminuar për arsye të ndryshme (p.sh. financiare, teknike apo të tjera – sipas rezultatit, askush s'u shpall fitues). Grupi “PACS and Workflow System” ishte ndër ofertuesit me çmim mjaft konkurrues, mirëpo çmimi i ulët nuk mund të kompensojë mospërmbushjen e specifikimeve. AK në asnjë moment nuk e ndryshoi asnjë kriter të tenderit për t'ia bërë më të vështirë këtij OE-je; përkundrazi, vetëm u siguria që kriteret ekzistuese të plotësoheshin. Pretendimi se AK “ndryshoi herë pas here arsyet” duhet kuptuar në kontekst:

- Në njoftimin e parë (pas vlerësimit fillestar) AK e pati eliminuar OE-në ndoshta pa shumë detaje, thjesht me arsyen e përgjithshme “ofertë e papërgjegjshme”. OE u ankua dhe OSHP kërkoi rivlerësim.
- Në rivlerësimin e dytë (30.12.2024), AK dha arsyetim shumë më të detajuar teknik për eliminimin e OE-së, duke listuar 7 pika (që përfshinin si referencat ashtu edhe çështje teknike të bezel-it, sensorit, modularitetit të sistemit, mungesës së përshkrimeve të sigurisë dhe frekuencës së procesorit). Kjo tregon se AK, në përgjigje të vendimit të OSHP, e shqyrtoi me kujdes ofertën

dhe identifikoi çdo mangësi të mundshme. Është e drejtë e AK të evidentojë mangësi që ndoshta nuk ishin kapur ose theksuar në vlerësimin fillestar – kjo nuk përbën shkelje, për sa kohë që këto mangësi janë reale dhe brenda kornizës së kushteve të tenderit.

- Në njoftimin e fundit (05.06.2025), arsyetimi u fokusua disi ndryshe: 1) dëshmi të pamjaftueshme ligjore të referencave; 2) mospërputhje e datave në listën e referencave; 3) katalogët me specifika që nuk përputhen me kërkesat.

Vërehet se disa nga pikat që ishin përmendur më herët (p.sh., modulariteti i arkitekturës apo integrimi me pajisje specifike mjekësore) nuk u përmendën sërish. Kjo mund të jetë sepse OE, gjatë procesit të ankimimeve dhe sqarimeve, ndoshta ofroi informacione shtesë që I sqaruan ose adresuan disi ato pika, ose ndoshta komisioni e pa të arsyeshme të mos I theksonte më ato. Në vend të tyre, komisioni u përqendrua tek pikat më të forta dhe të padiskutueshme (referencat dhe specifikimet e pajisjeve).

- Ky ndryshim theksesh në arsyetim nuk përbën ndryshim të kriterëve, as shpikje të kushteve të reja – të gjitha çështjet e ngritura (para dhe tani) rrjedhin nga të njëjtat kërkesa fillestare të tenderit. Nuk ka asgjë të paligjshme që pas një rivlerësimi të dytë, AK të evidentojë se “ndoshta gabimisht më parë s’kishim trajtuar këtë devijim, tani e kemi vërejtur”. Kjo tregon në fakt kujdes më të madh në rivlerësim, jo diskriminim. Po të ishte diskriminim, AK mund të kishte eliminuar OE-në që në fillim ose e lodhur veten me analiza – por këtu kemi të kundërtën: AK ka shqyrtuar disa herë ofertën, edhe pas udhëzimeve të OSHP, për t’u siguruar që e vlerëson drejt. Që rezultati mbetet eliminimi është pasojë e faktit se oferta realisht ka pasur probleme të shumta, jo e ndonjë qëllimi diskriminues.

Është e rëndësishme të theksohet se parimi i barazisë/impacjalitetit i kërkon AK-së që të mos bëjë as “lëshime të paligjshme” për asnjë OE. OE pretendon se po diskriminohet sepse po "gjen gjithmonë një arsye për ta eliminuar". Mirëpo, po të shohim provat: ka pasur mjaftueshëm arsye legjitime për eliminim. Nëse AK do të injoronte këto mangësi dhe do shpallte OE-në fitues, atëherë do të ishte vënë në pikëpyetje barazia ndaj operatorëve të tjerë (që mund të jenë eliminuar për gabime ndoshta më të vogla, ose që s’patën mundësi të dinin se disa kërkesa do toleroheshin). Pra, AK-ja në fakt e mbrojtë parimin e barazisë duke mos bërë përjashtim për OE-në në zbatimin rigoroz të kriterëve. Ligji (neni 7(6) I LPP) kërkon që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve dhe specifikimeve. Pikërisht këtë ka zbatuar AK – ka kërkuar përputhjen e plotë, nuk e gjeti atë tek OE, dhe për rrjedhojë nuk e zgjodhi.

Së dyti, sa i përket nenit 67.7 të Rregullores 001/2022, ky nen (cituar edhe nga vetë OE) thotë: "Kthimi në rivlerësim nga OSHP nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar". OE duket se e interpreton këtë në mënyrë se "AK s’duhet të ndryshonte mendje apo arsye". Ky është një keqkuptim. Në fakt, kjo dispozitë ka kuptimin e shpjeguar më herët – që rivlerësimi nuk i garanton asnjë OE-je një rezultat ndryshe, pra nëse fillimisht ishte eliminuar, mundet prapë të mbetet i eliminuar pas rivlerësimit nëse arsyet që e përligjin eliminimin vazhdojnë ose konstatohen. Dhe në rastin tonë, pikërisht kjo ndodhi: rezultati final (eliminimi i OE-së dhe anulimi i tenderit) është i njëjtë me rezultatin fillestar. Nuk ka shkelje të nenit 67.7 – përkundrazi, AK e ndoqi atë. Po, argumentet specifike të AK evoluon pak nga hera e parë te e dyta dhe e treta, por kjo nuk është e ndaluar askund. Ligji kërkon që kur AK jep vendimin e tij, ta arsyetojë mirë e drejt. AK e ka përmirësuar arsyetimin e vet në çdo raund, duke e detajuar dhe fokusuar te pikat kyçe. Kjo është në funksion të ligjshmërisë dhe transparencës, jo në

kundërshtim me to. Së treti, nuk duhet anashkaluar fakti që OE PACS and Workflow System ka pasur disa raste shqyrtimesh ankimuese (në AK dhe në OSHP) dhe secilën herë i është dhënë përgjigje.

Pretendimi se AK "ka për qëllim ta eliminojë me çdo kusht" tingëllon si supozim mbi motive, por çfarë shohim në dokumente? – shohim që AK ka renditur shkaqe objektive. Nëse nesër do ketë një seancë tek OSHP-ja mbi këtë çështje, paneli i OSHP do të verifikojë: a janë të vërteta këto mangësi? Nëse po, atëherë AK ka bërë gjënë e duhur dhe motivet subjektive s'kanë rëndësi, sepse vendimi i AK do qëndrojë mbi themelet faktike dhe ligjore. Në dritën e këtyre argumenteve, pretendimi i OE për shkelje të nenit 7 të LPP-së bie poshtë.

Në fakt, do të ishte shkelje e parimit të barazisë po të vepronte ndryshe AK (p.sh. t'i jepte kontratën një OE-je me mangësi, duke injoruar shkeljet e specifikimeve). Gjithashtu, neni 67.7 i Rregullores nuk e ndalon identifikimin e mangësive të reja në rivlerësim, por thjesht thekson se rivlerësimi nuk do të thotë që patjetër do ndryshohet rezultati – dhe këtu rezultati s'u ndryshua, me plot të drejtë.

Së fundi, dua të shtoj se Autoriteti Kontraktues e ka përmbushur edhe detyrimin e transparencës ndaj OE-së: në njoftimin e datës 05.06.2025 (letra B42 drejtuar OE-së) janë renditur qartë arsyet e eliminimit me gjithë shpjegimet teknike, siç u citua në këtë raport. Kjo i ka mundësuar OE-së të kuptojë saktë pse u skualifikua dhe të ushtrojë të drejtën e tij të ankimimit me dijeni të plotë. Pra, AK s'ka asgjë për të fshehur – vendimi i tij mbështetet në fakte të matshme dhe në ligj, jo në preferenca apo paragjykim.

Konkluzion dhe Rekomandim

Duke u bazuar në sa më sipër, konkluzioni i këtij raporti është se vendimi i Autoritetit Kontraktues (Ministritë së Shëndetësisë) për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 206-23 - 13309-1-1-1 është i drejtë, i ligjshëm dhe i mbështetur plotësisht në gjetjet faktike dhe kornizën ligjore.

Oferta e paraqitur nga Grupi i OE "PACS and Workflow System" rezultoi të jetë jo e përgjegjshme (jo-komformuese) me kërkesat e dosjes së tenderit, për arsye të shumta si: mospërmbushja e kërkesave për referenca të suksesshme, mospërputhje të specifikimeve teknike kyçe (serverët, procesorët, monitorët), dhe mungesë e përmbushjes së disa kushteve të sigurisë e performancës.

Këto mangësi janë dokumentuar dhe provuar nga Komisioni i Rivlerësimit me evidencë konkrete (dokumente zyrtare, katalogë teknikë, etj.), dhe përbëjnë devijime thelbësore nga kushtet e tenderit – pra, nuk janë rregullueshme pa ndryshuar ofertën (gjë që ligji e ndalon pas afatit të dorëzimit).

Në këto rrethana, Ministria e Shëndetësisë nuk kishte asnjë bazë ligjore për të shpallur fitues këtë ofertë ose ndonjë ofertë tjetër, pasi asnjë nuk ishte vlerësuar e përgjegjshme. Sipas LPP dhe rregullave, kontrata publike mund t'i jepej vetëm një OE-je që plotësonte të gjitha kërkesat, çka në këtë garë nuk ndodhi. Çdo veprim tjetër (p.sh. negociimi informal për të rregulluar ofertën, ose shpallja fituese me kushte) do të ishte i paligjshëm. Prandaj, anulimi i aktivitetit të prokurimit ishte jo vetëm i arsyeshëm, por i detyruar nga ligji (LPP nenet 59, 60 dhe 62) kur ndodhemi para mungesës së ofertave të përgjegjshme. Autoriteti Kontraktues e ka justifikuar këtë anulim duke iu referuar pikërisht "mungesës së ofertave të përgjegjshme" në njoftimin e tij zyrtar, që është

formulimi i saktë për të përfshirë gjithë sa diskutuam: oferta e OE "PACS and Workflow System" u shpall e papërgjegjshme dhe ofertues të tjerë të vlefshëm nuk kishte.

Në dritën e këtyre fakteve, rekomandohet fuqimisht që vendimi për anulimin e prokurimit të mbështetet dhe të konfirmohet edhe gjatë shqyrtimit të ankesës aktuale. Çdo pretendim i operatorit ankues është sqaruar dhe rrëzuar me argumente ligjore e teknike: asnjë shkelje nga ana e AK nuk rezulton, ndërsa zbatimi konsekuent i ligjit për prokurimin publik imponon mosdhënien e kontratës në rrethana të tilla.

Në vijim paraqitet një tabelë përmbledhëse e gjetjeve kryesore teknike dhe ligjore, e cila sintetizon arsyet kryesore të eliminimit të ofertës së OE dhe justifikon anulimin e aktivitetit:

Siç dëshmohet nga tabela e mësipërme, çdo gjetje teknike dhe profesionale mbështetet në dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores në fuqi. Autoriteti Kontraktues ka vepruar conform këtyre dispozitave duke eliminuar një ofertë jopërputhëse dhe duke anuluar tenderin në mungesë të ofertave të vlefshme. Për rrjedhojë, ne rekomandojmë konfirmimin e vendimit të anulimit dhe refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të OE "PACS and Workflow System" si të pabazuar. Ky qëndrim siguron respektimin e ligjit, mbron integritetin e procesit të prokurimit dhe garanton që në kontratat publike të mos pranohen oferta që nuk i plotësojnë kërkesat e parapara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0548, ndërsa me datë 11.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0548. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim .

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE NOVUS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0548, ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik si dhe raportin dhe shkresat në rivlersimin nga Autoritet Kontraktues. Por bazuar në vendimet e më parshme të Panelit Shqyrtues , AK nuk ka vepruar konformë dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik dhe sipas Rregullore ë Prokurimit Publik , ku e parasheh që në rastin

e kthimit të një aktiviteti të prokurimit në rivlersim bazuar në nenin 40 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve sipas RRPP-së, nr.002/2024, ku përcakton decidivishtë mënyrën e zhvillimit të procedurës në fazën e ri-vlersimit sipas Vendimeve të OSHP-së në paragrafin 40.2.1 si : Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHPsë, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHPsë. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), andaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK me aktet dhe veprimet e saj nuk i ka respektuar nenin 4 të LPP-së dhe nenin 8 të Rregullorës së Prokurimit Publik si dhe vendimet e panelit shqyrtues OSHP: 2024/0712 dhe 2025/0060. Për më tepër eksperti shqyrtues, konstaton se vendimet e OSHP-së janë përfundimtare/detyruese për palët dhe si të tilla i nënshtrohen kontrollit gjyqësor me mjete juridike bazuar në nenin 119 të LPP-së.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues duke vepruar në kuptim të nenit 16 paragrafit 2 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e njofton panelin shqyrtues se palët janë të njejta (AK-OE ankues) objekti i shqyrtimit të lëndës është i njejtë dhe është shqyrtuar më parë me vendimet nr. 2024/0712 dhe 2025/0060, andaj për këto arsye, i propozon panelit shqyrtues që këtë çështje të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, ku kjo është konstatuar edhe në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është

hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin (B58) të AK-së dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim duke kërkuar nga AK -ja që gjatë Rivlersimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - NOVUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: